

“BIG APPLE” SHPK

AKT THEMELIMI

PËR

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Themeluesit kanë vendosur të krijojnë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sot më datë 17/01/2025 në bazë të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, në bazë të kushteve që vijnë;

Themeluesit:

1. Joris Gjeçi, atësia Jozef, lindur në Lezhë, më datë 15.11.1995, dhe banuese në adresën Njeesia Administrative Nr. 5, Rr. “Irfan Tomini” Nd. 28, H. 3, Ap. 12, Tiranë, Shqipëri, me Letërnjoftim ID Nr. 037954255, dhe Nr. Personal J51115040H, dhe
2. Huljo Berati, atësia Lulzim, lindur në Tiranë, më datë 26.05.2000, dhe banuese në adresën Njeesia Administrative Nr. 5, Blv. “Bajram Curri” Nd. 48, H. 2, Ap. 4, Tiranë, Shqipëri, me Letërnjoftim ID Nr. 033140553, dhe Nr. Personal K00526047J.

NENI 1

Joris Gjeçi dhe Huljo Berati do të krijojnë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, të cilën do ta quajë: “BIG APPLE” Sh.p.k., e cila do të ketë si objekt:

Aktivitet në fushën e sheerbime ushqimore, fast food. Import-eksport, tregti me pakicë e shumicë të produkteve ushqimore. Gjithashtu shoqëria mund të ushtroj edhe çdo lloj aktiviteti tjetër të pashprehur më sipër, që lejohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim si dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore. Shoqëria ka të drejtë të bashkëpunojë me persona fizikë, juridikë, me çdo shoqëri tjetër, brenda dhe jashtë vendit.

NENI 2

Shoqëria e ka selinë në Tiranë, Shqipëri në adresën : Njësia Administrative Nr. 2, Rruga Jul Variboba, Nd. 3, Ap. 3, Tiranë.



Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 3

KOHËZGJATJA Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

NENI 4

KAPITALI THEMELTAR i shoqërisë është 1,000 lekë.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga “ortakët” e shoqërisë :

- 1- Joris Gjeçi, zotëruese e 1 kuote, me vlerë nominale 500 lekë dhe me vlerë të përgjithshme 500 lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, dhe
- 2- Huljo Berati, zotëruese e 1 kuote, me vlerë nominale 500 lekë dhe me vlerë të përgjithshme 500 lekë, që përbën 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortakët përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.



NENI 5

Administrator i shoqërisë do të jetë:

1. Huljo Berati, atësia Lulzim, lindur në Tiranë, më datë 26.05.2000, dhe banuese në adresën Njeesia Administrative Nr. 5, Blv. “Bajram Curri” Nd. 48, H. 2, Ap. 4, Tiranë, Shqipëri, me Letërnjoftim ID Nr. 033140553, dhe Nr. Personal K00526047J, emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

NENI 6

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij Akt Themelimi, edhe me norma të përcaktuara në një Statut, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërisë dhe si i tillë do të fitojë personalitetin




juridik me rregjistrim në “Qendrën Kombëtare të Biznesit” në bazë të Ligjit 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar, ditën kur shoqëria do të legalizohet si person juridik shqiptar.

ORTAKËT E SHOQËRISË

“BIG APPLE” SHPK

JORIS GJEÇI



HULJO BERATI

